



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:105342

Datë: 18.02.2025

Numri i dokumentit: 06859919

Ac.nr.6859/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Fatmir Baloku dhe Enes Mehmeti, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.H nga fshati M., Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Mustafë F. Nuhiu, avokat nga Gjilani, kundër të paditurit V.Z nga fshati M., Komuna e Gjilanit, tani me vendbanim të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Selami Rexhepi, avokat nga Gjilani, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.*/18 i datës 09.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit B.H nga fshati M., Komuna e Gjilanit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.*/18 i datës 09.08.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.*/18 i datës 09.08.2022, ka vendosur si vijon:

I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit B.H nga fshati M., Komuna e Gjilanit, e paraqitur kundër të paditurit V.Z, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet e drejta e pronësisë në bazë të kontratës verbale dhe mbajtjes, në ngastrën kadastrale P – *****_*****_*, me sipërfaqe prej 20963 m², Zona Kadastrale M., Komuna e Gjilanit.

II. Obligohet paditësi që të paguaj taksën shtesë në vlerë prej 20.00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar ankesë ka ushtrur paditësi duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se: *Ankesa e paditësit është e pabazuar.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B.H nga fshati M., Komuna e Gjilanit, përmes të autorizuarit të tij me datën 28.08.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, kundër të paditurit V.Z nga fshati M., Komuna e Gjilanit, tani me vendbanim të panjohur, me kërkesë dhe arsye sikurse në padi.

Meqë vendbanimi i të paditurit ka rezultuar i panjohur sipas padisë, gjykata të paditurit i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm dhe se duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.*/18 i datës 09.08.2022, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat e administruara ka ardhur në përfundim se kërkesëpadija e paditësit për vërtetimin e pronësisë nuk ka bazë ligjore, për faktin se me asnjë provë nuk u vërtetua se paditësi e ka blerë pronën e kërkuar dhe se është në posedim të pandërprerë të saj. Ka arsyetuar se nga deklarata e dëshmitarit të propozuar si provë nga paditësi, i cili as nuk kishte qenë i pranishëm në momentin e lidhjes së kontratës së pretenduar, nuk u vërtetua asnjë fakt relevant mbi bazën e së cilit do të mund të vërtetohej se paditësi në kohën dhe vendin e shitblerjes i ka paguar çmimin të paditurit, madje nuk u vërtetua as posedimi i pa ndërprerë në pronën kontestuese, të njëjtat fakte nuk u vërtetuan as me deklaratën e vet paditësit i dëgjuar në cilësi të palës, ku paditësi pretendonte se nuk kanë qenë të penguar asnjëherë në shfrytëzimin dhe posedimin e kësaj prone, dhe se nuk e ka bërë të besueshëm faktin dhe mënyrën e shfrytëzimit të ngastrës dhe as që e ka paguar çmimin për blerjen e asaj ngastre. Duke ju referuar dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore të vitit 1980, si ligj material i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik të pretenduar, konkretisht dispozitës së nenit 28 dhe nenit 70 i LMTHJP gjykata ka arsyetuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet e parapara me dispozitat e sipërcituara ligjore ngase paditësi nuk ja ka bërë të besueshme gjykatës se ka posedimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë në ngastrën kontestuese, e aq më pak mirëbesimin në ushtrimin e këtij posedimi të pretenduar. Në fund ka shtuar se në rastin konkret paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka arritur ta bindë gjykatën se i njëjti është pronar i parcelës kadastrale të pretenduar objekt i këtij kontesti ashtu siç është i obliguar konform dispozitës së nenit 7.1; 319 par.1 dhe 322 par.1 të Ligjit për

Procedurën Kontestimore (LPK) andaj nga të lartcekurat kërkesëpadinë e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar.

Përkitazi me refuzimin e propozimit të palës paditëse për nxjerrjen e provës me dëgjimin e dëshmitarëve, të bërë në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata ka arsyetuar se në rastin konkret, përfaqësuesi i paditësit nuk e ka bërë të besueshme dhe nuk i është referuar asnjë rrethane se pse këta dëshmitarë nuk i ka propozuar në seancën përgatitore, andaj bazuar në nenin 402.1 lidhur me nenin 482 par. 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, një propozim i tillë del të jetë i pa bazuar.

Për shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, me pretendimin se dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyet e aktgjykimit, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata në arsyetim të vendimit ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare duke specifikuar se si i ka vërtetuar faktet, cilat prova i ka shfrytëzuar, si i ka vlerësuar ato për vërtetimin e secilit fakt dhe për fuqinë provuese të tyre, e po ashtu ka arsyetuar se si ka arritur në përfundimin për refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar.

Nuk janë pranuar pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit të gjitha faktet thelbësore kontestuese i ka provuar me mjete të përshtatshme dhe të besueshme provuese dhe rrjedhimisht edhe i ka arsyetuar të njëjtat në raport me normën e zbatuar. Gjykata në procedurën e provave ka bërë nxjerrjen e provës me këqyrje në vend me ndihmën e ekspertit të gjeodezisë nga e cila provë ka vërtetuar faktin se ngastra lëndore sipas regjistrave kadastral evidentohet në emër të pronarit V.Z me 1/1 pjesë dhe ka sipërfaqe prej 20963 m², kjo parcelë nuk është e përkufizuar dhe e njëjta është djerrinë. Për vërtetimin e fakteve të pretenduara nga paditësi në padi gjykata ka bërë nxjerrjen e provës me dëgjimin e paditësit në cilësi të palës dhe dëgjimin e dëshmitarit të propozuar nga paditësi M.A, nga deklaratat e të cilëve nuk janë vërtetuar faktet relevante dhe kruciale për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në rastin konkret, pra nuk u vërtetua se paditësi në kohën dhe vendin e pretenduar të shitblerjes i ka paguar çmimin të paditurit, nuk është vërtetuar posedimi i pa ndërprerë i paditësit në pronën kontestuese, pra nuk u vërtetua mënyra e shfrytëzimit të ngastrës nga ana e paditësit dhe as që paditësi e ka paguar çmimin për blerjen e

asaj ngastre, andaj vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë dhe përfundimi i nxjerrë nga vlerësimi i tyre përkitazi me kërkesën e padisë është i pranueshëm edhe për Gjykatën e Apelit.

Nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsye se: me dispozitën e nenit 70 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridiko civil shprehimisht parashihet se: *“Posedimin e sendit e ka çdo person që ushtron drejtpërdrejt zotërimin faktik të sendit (posedimi i drejtpërdrejtë). Posedimin e sendit e ka edhe personi që zotërimin faktik të sendit e ushtron nëpërmjet personit tjetër, të cilit në bazë të uzufuktit kontratës së shfrytëzimit të banesës, qirasë, ruajtjes, huapërdorjes ose veprimit tjetër juridik la ka hënë sendin në posedim të drejtpërdrejtë (posedimi i tërthortë)” dhe nenin 28 i LMTHJP i vitit 1980 ku parashihet se: “Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”, çka në rastin konkret paditësi nuk e ka bërë të besueshme se në ngastrën lëndore e ka posedimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë dhe as mirëbesimin në ushtrimin e posedimit të pretenduar.*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje juridike dhe se drejtë ka konstatuar se paditësi në rastin konkret nuk ka arritur ta vërtetojë posedimin në ngastrën kontestuese dhe eventualisht mirëbesimin në ushtrimin e këtij posedimi të pretenduar, e për të cilin ka qenë i obliguar në kuptim të nenit 7 paragrafi 1, e lidhur me nenin 319 paragraf 1 të LPK-së.

Me dispozitën ligjore të nenit 7.1 të LPK-së shprehimisht parashihet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Me dispozitën ligjore të nenit 319 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së shprehimisht thuhet se: *“Secila nga palët ndërgjygjëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit”*. Ndërsa me dispozitën ligjore të nenit 322.2 të LPK-së shprehimisht përcaktohet se: *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diçka tjetër”*.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pabazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit është i drejtë dhe i argumentuar. Përfundimisht, kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të palës paditëse përfshirë edhe pretendimin se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 428. 2 të LPK-së, mirëpo i vlerësoi si të pabazuara për faktin se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të detajuara në arsyetimin e aktgjyqimit përkitazi me këtë pretendim të palës paditëse, e me të cilat qëndrime dhe vlerësime të dhëna nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë pajtohet në tërësi dhe janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë, ndërsa pretendimet e tjera ankimore, kolegji i kësaj gjykate vlerësoi se nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6859/22, me datë 10.02.2025.

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka, d.v.